



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

Përmbledhje e takimit periodik me përfaqësuesit e mediave, datë 13.11.2024.

Me datë 13 nëntor 2024, në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, u zhvillua takimi periodik me përfaqësuesit e mediave, i organizuar nga gjyqtari për mediat, z. Erjon Bani.

Gjatë mbledhjes, ndër problematikat kryesore që u ngritën për trajtim nga ana e gazetarëve ishin: publikimi i të gjithë emrave të të pandehurve për secilën nga çështjet që publikohen në listën e orarit të gjyqeve, publikimi i shortit elektronik dhe prania e kamerave në seancat gjyqësore.

Lidhur me publikimin e të gjithë emrave të të pandehurve në listën e orarit të gjyqeve, u informuan gazetarët se, gjykata do të vërë menjëherë në lëvizje strukturat përkatëse të teknologjisë së informacionit në Këshillin e Lartë Gjyqësor, të cilat monitorojnë sistemin elektronik të gjykatës.

Sa i përket publikimit të shortit elektronik, u informuan përfaqësuesit e mediave se, publikimi i shortit elektronik bëhet në mënyrë periodike në faqen zyrtare të gjykatës https://www.gjp.gov.al/Kendi_informativ/Lista_e_Shortit/.

Lidhur me kërkesën për praninë e kamerave në seancat gjyqësore, përfaqësuesit e mediave u informuan mbi mënyrën e paraqitjes së kërkesës për rregjistrimin e seancave gjyqësore nga media, në zbatim të nenit 14 të Udhëzuesit Standart të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili parashikon rregjistrimin dhe transmetimin e seancës, vetëm kur nuk bie ndesh me rregullat e procesit të rregullt ligjor.

Gjatë diskutimeve të këtij takimi, gjyqtari për mediat gjithashtu, u solli në vëmendje përfaqësuesve të mediave rëndësinë e respektimit të parashikimeve të Udhëzuesit Standart të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe rëndësinë e përcjelljes së informacionit sa më korrekt në publik, duke mos shkelur barazinë e palëve pjesëmarrëse në një proces gjyqësor penal.

Po ashtu, u informuan përfaqësuesit e mediave se, Sektori i Teknologjisë së Informacionit të kësaj gjykate, në bashkëpunim dhe me strukturat përkatëse të teknologjisë së informacionit në Këshillin e Lartë Gjyqësor po punojnë për të bërë të mundur që, nga fillimi i vitit që vjen, të publikohen online, në faqen zyrtare të gjykatës të gjitha vendimet gjyqësore të dosjeve të themelit.

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar do të vijojë të përkrahë në mënyrë të vazhdueshme veprimtarinë e mediave, me qëllim transparencën dhe informimin objektiv të publikut. Kjo gjykatë mbetet e angazhuar ndaj të gjitha shqetësimeve apo problematikave që mund të hasin mediat gjatë veprimtarisë së tyre.